

AKTI I THEMELIMIT

DHE

STATUTI I SHOQERISE

BALTHAZAR Sh.p.k.

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit", une e nenshkruara shpall si me poshte vijon:

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Formohet shoqeria e quajtur "**BALTHAZAR**" Sh.p.k. (qe me poshte do te quhet "Shoqeria") me ortake:

Z. Genci Luto, shtetas shqiptar, lindur me 05.01.1978 ne Tirane, dhe banuese ne Tirane me nr personal nr. **H80105051R**, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar

SELIA E SHOQERISE

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen : **Njesia administrative nr.5 , Rr Pjeter Bogdani , Pall nr 5 , Kati 3 , Ap 7, Tirane.**

Gjate ushtrimit te aktivitetit te saj Shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar kohore, e cila fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Bisnesit (QKB).

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE



Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Import-eksport, tregeti me pakice artikujve industrial , ushqimor, veshmbathje etj. Përpunim i produktit ushqimor miell dhe produkteve te tjera. Prodhim i brumrave. Bar, Restorant. Veprimtari ne fushen e transportit te mallrave dhe te udhetareve. Cdo veprimtari tjetër qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortakë, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakëve.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise është 100.000 (njëqind mije) leke dhe i ndarë në 1 (nje) kuota me vlere nominale 100.000 lekë . Cdo ortak ka të drejtën e votës.

Kontributi i ortakëve ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

- **Z. Genci Luto** zoteron 1 kuote e barabarte me 100 % te kapitalit fillestar te shoqerise, me vlere 100.000 Leke.

Neni 7

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakëve.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bisnesit (QKB).

Neni 9

Ortakët e shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoqerise per fitimin e realizuar.

Neni 10

Kuotat e cdo anetari perputhen me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise. Kuotat e tij anetari i shoqerise mund t'ua ofroje te treteve. Anetaret e shoqerise kane perparesi per blerjen e kuotave perpara personave te trete jashte shoqerise. Ortaku qe deshiron te transferoje ose te shese kuotat e tij i drejton nje kerkese me shkrim Administratorit duke sakteluar cmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe te jete i njejte me ate qe do t'i ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e blesesit. Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Edhe e drejta e perparesise per nenshkrimin e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Administratorit.

E drejta e perparesise per nenshkrimin e kuotave eshte ne proporcion me kuotat qe zoteron secili prej ortakeve ne kete shoqeri. Administratori pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh dhe ne rast se ortaket do ti blejne keto kuota, i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjere per te blere te gjitha ose pjeserisht kuotat e tij. Transferimi dhe shitja e kuotave mund te behen me akte noteriale ose pa akt noterial dhe nje kopje e ketij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.

Neni 11

Emertimi i shoqerise tregtare, forma ligjore e shoqerise, numri unik i identifikimit, vendndodhja e shoqerise, emri i administratorit, duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri, nepermjet perdorimit te letres apo mjeteve elektronike, dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 12

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejttat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

Organet e shoqerise jane:

1- Asambleja e Ortakeve.

2- Administratori.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 13

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve e cila mund te thirret nga cdo anetar i shoqerise qe perfaqeson te pakten 5% te kapitalit te shoqerise. Anetaret duhet te njoftohen me



shkresë ose nepermjet postes elektronike, jo me vonë se 7 dite perpara dhe ne lajmerim duhet te jete shkruar vendi, ora dhe ceshtjet e rendit te dites qe do te trajtohen ne mbledhje.

Neqoftese Asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim kur çdo anetar i shoqerise eshte prezent dhe jane dakort te marrin vendime pavaresisht parregullise.

TE DREJTAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE

Neni 14

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

1) *Asambleja e Zakonshme:*

Mblidhet te pakten 1 here ne vit, dhe sa here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.

Asambleja e zakonshme e ortakeve merr vendime te vlefshme kur jane prezent apo te perfaqesuar me prokure ortakët qe zoterojne me shume se 30 perqind te kuotave ne kapitalin e shoqerise.

Kompetencat e Asamblese se Zakonshme:

Asambleja e Zakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhteme:

- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetence te Asamblese.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Vendos edhe per cdo ceshtje tjeter qe nuk sjell ndryshime ne statutin e shoqerise ose nuk eshte lene ne kompetence te Asamblese se Jashtezakonshme

2) *Asambleja e Jashtezakonshme:*

Ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme vendimet do te jene te vlefshme ne rast se ato do te merren nga ortakët qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar.

Asambleja e Jashtezakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhtme:

- Te marre ne shqyrtim dhe ka te drejte te miratoje te gjitha ndryshimet e statudit.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet.
- Realizon blerjen, shitjen dhe transferimin e pasurive te paluajtshme te shoqerise etj. dhe vendos ne lidhje me keto ceshtje;
- Vendos ne lidhje me çdo ceshtje te lidhur me pasurine e shoqerise, marrje hua, vendosje hipoteke, barre siguruese etj .
- Vendos per pjesemarrjen ne shoqeri te tjera per hapje dege, filiale, zyra perfaqesimi etj .

- Si dhe çdo çështje tjetër që nuk është në kompetencën e Asamblesë së Zakonshme.

Neni 15

Vendimet e asamblesë së jashtëzakonshme të Ortakeve të cilat janë marrë në një mbledhje të thirrur në mënyrë të rregullt dhe konform kontratës së themelimit, Statutit e të ligjeve janë të detyrueshme për të gjithë ortakët e tjerë, edhe për ata që nuk kanë diskutuar ose nuk kanë qenë dakord.

Cdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër që nuk është administrator. Asnjë i dërguar nuk mund të përfaqësojë më shumë se një ortak.

Në Asamblesën e Ortakeve marrin pjesë nëse është e nevojshme për të dhënë mendim eksperte, revizore etj.

Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime si dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zoteron.

Një ortak mund të përfaqësohet nga një ortak ose nga një person tjetër me prokurë të posaçme.

Neni 16

Marrja e vendimeve të Asamblesë, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të behen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qellim.

ADMINISTRIMI

Neni 17

Shoqëria administrohet nga administratori i cili caktohet në statutin e shoqërisë dhe më pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qëndron në detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërsëritjeje. Në rast se gjatë kësaj periudhe shfaqen probleme paaftësie nga ana e tij, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin që i është shkaktuar shoqërisë nga paaftësia e tij pasi është dhënë mendimi për këtë dem edhe nga specialistët perkates.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar me të tretet në emër të shoqërisë dhe në interes të saj në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe Statuti i shoqërisë ua jep shprehimisht ortakëve.

Administratori i shoqërisë është **Z. Genci Luto** me nr personal . **H80105051R**.

Administratori zgjidhet për një periudhë 5 (pese) vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.



Neni 18

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve.

Neni 19

Administratori ka te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme per furnizime publike private, te ndermarre veprime gjyqesore per dhe ne emer te shoqerise, etj. Administratori mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh. Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per cdo veprim gjyqesor apo jashtegjyqesor.

Administratori eshte i detyruar te mbaje konform ligjit te gjitha rregjistrat e domosdoshme per aktivitetin e shoqerise. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te mbaje inventare te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me parjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Administratori eshte pergjegjes per administrimin e shoqerise dhe informon ortaket per ecurine e veprimtarise tregtare te shoqerise. Gjate veprimtarise se tij ai vepron duke marre parasysh interesat e shoqerise, duke zbatuar parimet e detyrimit te besnikerise.

MARREDHENIET E PUNES

Neni 20

Maredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 21



Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i kesaj shoqerie.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Neni 22

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE

Neni 23

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

Neni 24

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve per mundesine e prishjes se shoqerise.

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 25

Ne rast se shoqeria priset per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidator dhe perгатit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

LIBRAT E SHOQERISE

Neni 26

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve te organit administrativ
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

- Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

TE DHENAT QE NJOFTOHEN VULLNETARISHT

Neni 27

Emri Tregtar: BALTHAZAR
E-Mail: luto.genci5@gmail.com
Telefon: +355686064480

GENCI LUTO




DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 28

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit", dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njeften menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

ORTAKU I SHOQERISE

GENCI LUTO



Tirane, me 10.08.2024